



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LIGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës
Mbledhja nr. 10
Prishtinë, më 17 qershor 2011
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENSHME, SIGURI DHE
MBIKQYRJËN E FORCËS SË SIGURISË TË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Fatmir Xhelili, Ganimete Musliu, Goran Marinković, Anton Quni, Vjollca Krasniqi dhe Rasim Demiri, anëtarë të Komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj dhe Haxhi Xhemajli.

Nga stafi këshillues i Komisionit morën pjesë: Avni Arifi dhe Naim Hoxha.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit përfundimtar të Projektligjit për shërbimet e sigurisë private;
3. Shqyrtimi i Raportit përfundimtar të Projektligjit për gjendjen civile;
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit përfundimtar të Projektligjit për shërbimet e sigurisë private

Kryetari – Ju e keni para vetes Raportin përfundimtar të Projektligjit për shërbimet e sigurisë private. Referues për këtë Projektligj ka qenë z. Rexhep Selimi. A ka dikush diçka të shtojë apo ta miratojmë dhe ta procedojmë kështu si është për seancë?

Rexhep Selimi – Unë singërisht kërkoj falje pse tash më duhet ta bëjë një vërejtje, që mendoj se është esenciale. Titulli i Projektligjit duhet të ndryshohet titulli dhe të bëhet Ligji për shërbimet private të sigurisë, sepse kështu siç është po nënkuptohet se siguria është private e jo shërbimi.

Fatmir Xhelili – Unë nuk mendoj se prish punë edhe kështu siç është, sepse gjithçka po nënkuptohet, por sido që të jetë ne e kemi kryer punën tonë. Propozoj që kjo çështje t'i mbetet lektorit, pra ta lëmë si punë të lektorit.

Rexhep Selimi – Ju lutem, gjatë shqyrtimit kemi diskutuar se a duhet të jetë *industri*, mirëpo unë nuk po insistoj te ndryshimi i shërbimit, por te *siguria private*.

Vjollca Krasniqi – Unë pajtohem plotësisht me z. Selimi. Po ashtu mendoj se duhet të shtohet edhe fjala *kompanitë*. Pra, të bëhet Shërbimet e Kompanive Private të Sigurisë. Gjithashtu besoj se gjatë lekturimit të shikohet edhe fjala licencë dhe licencim, sepse shpesh për të njëjtën çështje përdoren fjalë të ndryshme.

Kryetari – Propozoj që këtë çështje t'ia lemë lektorit dhe të rregullohet. Nuk besoj se paraqet problem nëse ndryshohet një fjalë.

Goran Marinković – Nuk mendoj se kemi të bëjnë me ndonjë ndryshim të madh. Nëse bëhet ndryshimi, atëherë ai duhet të hyjë në tërë tekstin e Projektligjit. Duhet ta sqarojmë se a mund ta ndryshojmë kështu apo duhet ta amendamentojmë.

Rexhep Selimi – Unë si referues nuk do ta votoj në këtë formë, sepse është gabim dhe nuk dua të dalë me një gabim të tillë. Edhe një herë kërkoj falje, sepse këtë ndryshim do të duhej ta bënte grupi i punës dhe jo tani. Mendoj se ky ndryshim është më se i nevojshëm.

Kryetari – Po e lëmë që të konsultohemi me ekspertë ose me MPB-në dhe ta gjejmë formën më të drejtë.

Fatmir Xhelili – Propozoj që unë me z. Selimi ta diskutojmë me dikë dhe ta vendosim.

Rexhep Selimi – Unë jam i sigurt se duhet ta ndryshojmë, sepse është gabim, si në përmbajtje, ashtu edhe në aspektin gjuhësor. Nuk kemi nevojë për konsultime shtesë as me ekspert, as me zyrtarë të MPB-së.

Anton Quni – Pajtohem që të shkojë propozimi i z. Rexhep Selimi. Mendoj se është formë më e drejtë.

Kryetari – Në rregull, a pajtoheni që të amendamentohet titulli i këtij Projektligji?

Anëtarët e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës e miratuan Raportin përfundimtar të Projektligjit për shërbimet e sigurisë private, bashkë me propozimin e z. Rexhep Selimi.

3. Shqyrtimi i Raportit përfundimtar të Projektligjit për gjendjen civile

Kryetari – Ju e keni para vetes Raportin përfundimtar të Projektligjit për gjendjen civile. Referues për këtë Projektligj kam qenë unë. Mendoj se ai është i gatshëm për procedim në lexim të dytë në seancë. A ka dikush diçka të shtojë apo ta miratojmë dhe ta procedojmë për seancë?

Anëtarët e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës e miratuan Raportin përfundimtar të Projektligjit për gjendjen civile.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera

Kryetari - Sot e kemi për shqyrtim në parim Projektligjin për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera. Mendoj se i plotëson kriteret e përgjithshme dhe si komision funksional duhet ta procedojmë për miratim në parim. Duhet ta caktojmë grupin e punës për punë të mëtutjeshme.

Anëtarët e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës e miratuan në parim Projektligjin për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera dhe e caktuan grupin e punës në këtë përbërje: Vjollca Krasniqi - referuese, Goran Marinkovi, Fatmir Xhelili dhe Anton Quni.

5. Të ndryshme

Kryetari - Pasi nuk ka çështje të tjera për diskutim, e mbyll takimin për sot. Ju faleminderit.

Mbledhja përfundoi në orën: 11:00

E hartoi:

Njësia Mbështetëse e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi